



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 11.06.2019

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

**“PËR PROJEKTLIGJIN PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË ARABISË SAUDITE PËR
SHMANGIEN E TATIMIT TE DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT
FISKAL NË LIDHJE ME TATIMIN MBI TË ARDHURAT DHE KAPITALIN”**

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 11.06.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin”, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Znj. Evis Kushi

Për të mbrojtur projektligjin në emër të Qeverisë, ishin prezent përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Z. Nikolla Lera, Znj. Dorina Toro, Znj. Brikena Jazxhi

II. Baza ligjore Kushtetuese

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 I saj dhe në përmbushje të nenin 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

III. Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Qëllimi i projektligjit

Projektligji ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin.

Përmes kësaj marrëveshje shmanget tatimi i dyfishtë pra shmanget detyrimi që e njëjta e ardhur të tatohet dy herë, për një individ apo një person juridik që ka aktivitet në të dy shtetet (në Shqipëri dhe/ose Mbretërinë e Arabisë Saudite) apo në kushtet që duke qenë rezident i njërit prej këtyre dy vendeve siguron të ardhura në shtetin tjetër.

Marrëveshjet për shmangien e tatimit të dyfishtë kanë një rëndësi dhe impakt të konsiderueshëm, në stimulimin dhe rritjen e aktiviteteve të biznesit të shoqërive shumëkombëshe, pasqyrojnë përgjegjshmërinë e shtetit, stimulojnë tregtinë, lëvizjen e lirë të njerëzve, kapitaleve, mallrave përfshirë paratë, duke ndikuar kështu pozitivisht edhe në stimulimin e marrëdhënieve ekonomiko-tregtare ndërkombëtare.

Për këtë arsye, Shqipëria ka ratifikuar ndër vite 41 marrëveshje për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, ku do të veçonim marrëveshjet me vendet e rajonit si me Bosnjë-Hercegovinën, Serbinë e Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën. Marrëveshjet për shmangien e tatimit të dyfishtë janë lidhur gjithashtu me shumë vende Evropiane, si me Greqinë, Italinë, Gjermaninë, Spanjën, Poloninë, Rumaninë, Hungarinë, Çekinë, Austrinë, Slloveninë, Luxemburgun, Holandën, Islandën, Britaninë e Madhe, Irlandën e Veriut etj., por nuk mungojnë marrëveshjet edhe me vende të tjera si Rusinë, Estoninë, Singaporin, Korenë e Jugut, Katarin, Emiratet e Bashkuara Arabe etj.

Përmes marrëveshjes objekt shqyrtimi përcaktohet pikërisht shmangia nga tatimi i dyfishtë, duke i dhënë të drejtën për tatimin e të ardhurave të caktuara vetëm njërit shtet apo duke e ndarë këtë të drejtë midis të dy shteteve, por pa e rënduar subjektin me tatim të dyfishtë. Është pikërisht kjo lehtësi që sjell impakt dhe ndikon edhe në parandalimin e evazionit fiskal në

lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin duke krijuar një bazë të plotë ligjore për trajtimin tatimor të individëve apo personave juridikë shqiptarë apo sauditë, të cilët kanë aktivitete biznesi apo të ardhura të tjera që janë objekt i legjislacioneve tatimore të të dy shteteve.

Përmbajtja e projektligjit

Marrëveshja përbëhet nga 30 nene gjithsej, të cilët përmbledhtazi trajtojnë:

- Në nenet 1, 2, 4 dhe 5, të marrëveshjes përcaktohet gama e personave të cilët afekton, përcaktohen tatimet e përfshira të ndara sipas secilës palë kontraktore, përkufizimet e përgjithshme ku do të veçonim përkufizimet e termave “rezidencë” për efekt fiskal si dhe i termit “selisë së përhershme” të biznesit që një individ, duke përcaktuar tatimin e këtyre të ardhurave në shtetin ku ajo ndodhet apo ka vendin e saj fiks të biznesit.
- Në nenin 6, të saj përcaktohet e drejta e plotë tatimore e tatimit mbi të ardhurat nga pasuritë e paluajtshme (qeratë, apo të ardhura të tjera) për Shtetin ku ndodhen pasuritë e paluajtshme, pavarësisht nga rezidenca e tatimpaguesit apo pronarit.
- Neni 7, 8 dhe 9, përcakton tipologjinë dhe mënyrën e ndarjes së fitimeve nga ndërmarrjet, të ardhurat nga transporti ndërkombëtar me avije dhe avion ku e drejta e plotë tatimore i jepet Shtetit ku ka rezidencën shoqëria ajrore apo detare që ushtron biznesin e transportit ndërkombëtar si dhe trajtojnë kushtëzimet lidhur me fitimet e ndërmarrjeve të asocuara.
- Nenet 10, 11 dhe 12, trajtojnë mënyrën e shmangies së tatimit të dyfishtë për të ardhurat nga dividendët, nga interesi, të ardhurave nga pretendimet e borxhit dhe të tarifave të licencave. (të ardhurat nga pronësia intelektuale – të drejtat e autorit, patentat).
- Neni 13 ka përcaktuar që e drejta tatimore për tatimin e të ardhurave nga tjetërsimi/shitja e pronave të paluajtshme i takon vendit ku ndodhen këto prona të paluajtshme, pavarësisht nga rezidenca e tatimpaguesit. Ndërsa neni 14, trajton të ardhurat nga shërbimet personale të pavarura, shërbimet profesionale që një resident i një shteti kontraktues realizon në shtetin tjetër.
- Në nenet 15-22, trajtohen të ardhurat nga shërbime personale të varura, tarifat e drejtuesve të kompanive, të ardhurat e artistëve dhe sportistëve, të ardhurat nga pensionet, etj. Nenet 23 dhe 24 trajtojnë të drejtën për tatimin e kapitalit (përfshirë tatimin mbi pronën), si dhe jepen mënyrat dhe procedurat e përgjithshme për eliminimin e tatimit të dyfishtë.
- Neni 26 përcakton dispozitat e përgjithshme të shkëmbimit të informacionit, ndërsa neni 27 përcakton se mos afektimin nga përcaktimet e kësaj marrëveshje në privilegjet financiare të anëtarëve të misionëve diplomatike apo posteve konsullore sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ose sipas dispozitave të marrëveshjeve të veçanta.

- Në nenin 29 jepen dispozitat e hyrjes në fuqi ndërkohë që në nenin 30 përcaktohet që marrëveshja nuk do të ketë kufizim në kohë pra do të jetë në fuqi për një periudhë kohe të pakufizuar.

IV. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Relatori i Komisionit, në fjalën e tij, shpjegoi se, projektligji vjen pas miratimit në parim të tij përmes Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 350, datë 23.05.2012 dhe nënshkrimit të saj në shkurt 2019, në Riad të Arabisë Saudite nga palët.

Marrëveshja mundëson shmangien nga tatimi i dyfishtë, duke i dhënë të drejtën për tatimin e të ardhurave të caktuara vetëm njërit shtet apo duke e ndarë këtë të drejtë midis të dy shteteve, por pa e rënduar subjektin me tatim të dyfishtë. Në terma më konkret marrëveshja afekton personat që janë rezident në një ose dy shtete kontraktuese pra në Shqipëri apo në Mbretërinë e Arabisë Saudite. Tatimet që përfshihen në këtë marrëveshje janë konkretisht tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin. Të tilla tatime do të konsiderohen tatimet mbi të ardhurat e të gjitha tatimeve të vendosura mbi të ardhurat e plota, mbi kapitalin ose mbi elementë të të ardhurave ose kapitalit, duke përfshirë tatimet mbi fitimin nga tjetërsimi i pasurisë se luajtshme ose të paluajtshme, tatimet mbi totalin e pagave ose pagesat e bëra nga ndërmarrjet si dhe tatimet mbi vlerësimin e kapitalit.

Për Shqipërinë kjo marrëveshje do të shtrihet mbi këto tatime:

- Tatimin mbi të ardhurat duke përfshirë tatimin mbi fitimin e shoqërive, tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimin e të ardhurave të kapitalit nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme ose të paluajtshme;
- Tatimin mbi aktivitetet e biznesit të vogël; dhe
- Tatimin mbi pasurinë.

Për Mbretërinë e Arabisë Saudite kjo marrëveshje do të shtrihet mbi këto tatime:

- Zakatin;
- Tatimin mbi të ardhurat përfshirë tatimin e investimit në gazin natyror

Kjo marrëveshje do të shtrihen edhe mbi tatime të njëjta apo thelbësisht të ngjashme të cilat do të vendosen pas nënshkrimit të marrëveshjes.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, theksuan rëndësinë e kësaj marrëveshjeje si dhe shpjeguan në mënyrë më të detajuar përfitimet që do të kenë individët apo personat juridik prej saj.

V. *Ndryshime të projektaktit (nen për nen)*

Pas shqyrtimit të projektligjit, Komisioni për Ekonominë dhe Financat për qëllime të saktësimit të teknikës legjislative, vendosi:

Preambula e projektligjit bëhet: ***“Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,”***

VI. *Përfundime*

Në përfundim Komisioni për Ekonominë dhe Financat, duke evidentuar faktin se kjo marrëveshje është në përputhje me Kushtetutën si dhe legjislacionin në fuqi për marrëveshjet ndërkombëtare si dhe duke vlerësuar se marrëveshja do të mundësojë shmangien e tatimit të dyfishtë për individët apo një person juridik që ka aktivitet në të dy shtetet (në Shqipëri dhe/ose Mbretërinë e Arabisë Saudite) apo në kushtet që duke qenë rezident i njërit prej këtyre dy vendeve siguron të ardhura në shtetin tjetër, me votat pro të të gjithë anëtarëve të pranishëm e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi.

RELATOR

Evis Kushi

Sekretar i Komisionit

Anastas Angjeli